

Vendim nr. 39, datë 14.07.2023
(V-39/23)

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Holta Zaçaj, Kryetare, Marsida Xhaferllari, Fiona Papajorgji, Elsa Toska, Sonila Bejtja, Ilir Toska, Genti Ibrahim, Marjana Semini, Sandër Beci, anëtarë, me sekretare Belma Lleshi, në datën 14.07.2023 mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 37 (A) 2023 të Regjistrimit Themeltar, që u përket:

KËRKUES: **ALEKS LICI, LEFTERIA LICI**

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

TELEMAH RAJDHO,
KËSHILLI I QARKUT GJIROKASTËR

OBJEKTI: **Saktësim në vendimin nr. 28, datë 18.05.2023 të Gjykatës Kushtetuese.**

BAZA LIGJORE: Neni 80 i ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*); neni 312 i Kodit të Procedurës Civile (*KPC*); neni 43 i Rregullores për Procedurat Gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese.

GJYKATA KUSHTETUESE,

e iniciuar kryesisht, pasi dëgjoi relatorin e çështjes Sandër Beci, shqyrtoi dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkesit Aleks dhe Lefteria Lici, me kërkesën e datës 07.07.2022 i janë drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*), me ankim kushtetues individual, për shfuqizimin e vendimit nr. 00-2022-2166 (79), datë 07.03.2022 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

2. Gjykata, me vendimin nr. 28, datë 18.05.2023, ka vendosur: “1. *Pranimin e kërkesës*. 2. *Shfuqizimin e vendimit nr. 00-2022-2166 (79), datë 07.03.2022 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë*. 3. *Dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Kolegjin Penal të Gjykatës së Lartë*.”.

3. Pas shpalljes së vendimit në datën 19.06.2023, Gjykata ka konstatuar një gabim në shkrim në dispozitivin e vendimit të saj, konkretisht në pikën 3 të tij, ku është vendosur: “3. *Dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Kolegjin Penal të Gjykatës së Lartë*”. Gabimi në shkrim lidhet me Kolegjin e Gjykatës së Lartë që është kompetent për rishqyrtimin e kësaj çështjeje, duke qenë i tillë Kolegji Civil dhe jo ai Penal referuar natyrës së çështjes gjyqësore në rastin konkret.

4. Në këto rrethana, Gjykata vlerëson se është në situatën kur kryesisht duhet të bëjë ndreqjen e gabimit në shkrim, sikurse një gjë e tillë lejohet nga neni 80 i ligjit nr. 8577/2000, sipas të cilit Gjykata ka të drejtë të ndreqë gabimet në shkrim, pa ndryshuar thelbin e vendimmarrjes, brenda 2 muajve nga shpallja e vendimit. I njëjti rregull parashikohet edhe në nenin 43 të Rregullores për Procedurat Gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese, sipas të cilit kur kërkesa ka të bëjë me një vendim përfundimtar, kompetente për shqyrtimin e saj është Gjykata. Gjithashtu, edhe neni 312 i KPC-së ka parashikuar se gjykata, me kërkesën e palëve ose kryesisht, mund të ndreqë në çdo kohë vetëm gabimet e bëra me shkrim ose në llogari, ose ndonjë pasaktësi të dukshme të vendimit.

5. Për sa më lart, Gjykata vlerëson se dispozitivi i vendimit të saj nr. 28, datë 18.05.2023 duhet të saktësohet në këtë mënyrë: “3. *Dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Kolegjin Civil të Gjykatës së Lartë*.”.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, bazuar në nenin 80 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenin 312 të Kodit të Procedurës Civile, si dhe nenin 43 të Rregullores për Procedurat Gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese, njëzëri,

V E N D O S I:

1. Saktësimin e pikës 3 të dispozitivit të vendimit nr. 28, datë 18.05.2023 të Gjykatës Kushtetuese, i cili bëhet si vijon: “3. *Dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Kolegjin Civil të Gjykatës së Lartë*.”.
2. Një kopje e këtij vendimi i bashkohet vendimit nr. 28, datë 18.05.2023 të Gjykatës Kushtetuese.

3. Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 14.07.2023

Shpallur më 14.07.2023